

BIBLIOTEKA  
SHTETIT


Gjikë Kurtiqi

Vjersha Satirike



THENGJIL  
I MBULUAR

891.985-7



Gjikë Kurtiqi ka lindur më 3 qershori 1943 në Vithkuq të Korçës. Ka mbaruar fakultetin e shkencave politike juridike dhe tani punon në redaksinë e revistës «Hosteni». Ka disa vjet që boton fejtone, skica, fabula dhe poezi satiro-humoristike në organet e ndryshme të shtypit të përditshëm dhe periodik. Vëllimi «Thëngjill i mbuluar» është vëllimi i tij i parë.

891.985-7

8SH-2  
K98

GJIKË KURTIQI

*THËNGJILL I MBULUAR*

Fabula, vjersha satirike, epigrame



20265-

Titulli 2000 folsë Tominë 10x100folsë Sipas: 2001-20  
Sipas Dëshmorës Qëndrues Botëtarisë  
SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»


## S'PERSERITET FABULA

(*Korbi dhe dhelpa*)

Korbi, kësaj here,  
me mëlçi në gojë,  
tek dega e lisit  
prapë vajti qëndroi.

Korbin, që nga larg  
e pa zonja dhelpër  
dhe pranë iu afrua,  
si te prall' e vjetër.

— Je një zog i rrallë,  
i bukur nga shtati...  
Por korbi mëlçinë  
me kthetër e kapi:




— Mos u lodh më kot,  
në tjetër kohë jemi,  
veç njëherë ma hodhe  
si desh Lafonteni.

## SA PËR DIJENË

Shkoi në park të kërkonte punë  
një elefant i murmë.

— Që sot — i thanë, — mund të fillosh,  
vendi i ariut është bosh.



Elefanti u prek në sedër

dhe tha:

— S'mund ta pranoj këtë ftesë,  
e quaj bile ofezë.

— Si të dëshironi,  
i thanë me gjakftohtësi,  
por... sa për dijeni,  
këtu sorkadhe kemi një dhi  
dhe drerin me brirët një pash,  
e bëmë dash.

## **DHELPRA DHE FIQTË**

Një fabul shkrova,  
e qava me lot,  
për dhelprën dhe fiqtë,  
që s'i kapte dot.

Dhe si u mundua  
e s'mundi t'i zërë  
tha: «S'janë pér mua;  
janë të pa bërë».

Dikush i nxituar  
mund ta ngrejë zënë:  
«Fabulen Ezopi  
me kohë e ka thënë».




Kjo s'është e värtetë,  
e di mirë gjithëkush,  
fabulën Ezopi  
e ka thënë me rrush.

Pra ka një ndryshim,  
kam vënë pak dorë,  
s'kam bërë vec përkthim,  
si disa autorë.

## H E L M I M I

Një mushkonjë  
e gjinisë mashkullore,  
jetën bashkëshortore  
me mushkonjën  
e tjetrës gjini,  
po e kalonte  
bukuri,  
aq sa zili ja kishin harmoninë,  
Por një ditë  
e prishi biografinë...  
Filloi t'i bërtasë  
mushkonjës grua:  
— Fjalë shumë s'dua,  
ke bërë, ç'ke bërë,  
t'i vëmë kapak,  
jam unë zot në konak  
dhe ti,  
o do ma dëgjosh zënë,



o marsh tek jot' èmë.  
Pa lejë  
s'do lëvizësh prej shtëpisë...  
Më duket, u bëmë  
si këmbët e dhisë.

— Ç'na gjeti kjo e keqe;  
ç'na gjeti!  
(Mushkoja grua  
u alarmua)  
Ne ishim bukur e mirë,  
duket, tek ndonjë fanatic  
gjak të helmuar ka pirë.

## **MINJTË E UGARIT**

I kini parë beharit  
minjtë e ugarit,  
si kërcejnë përpjetë,  
kur u tronditen foletë?

Na u mblodhën njëherë,  
kokë më kokë në një ferrë,  
kundër plugut të ngrejnë padi.  
— Shpesh nëpër këmbë na ka marrë,  
na prish rehatinë,  
neve që s'kemi hyrë në hambarë,  
qelibar e kemi biografinë...

Dhe filluan ta ngrejnë zënë,  
por s'qe thënë...  
Aty pranë një milingonë,  
që veshin i kishte vënë fjalës,  
u ngrit e tha:  
«E ç'më mburri me biografitë,  
ju, o parazitë?!



1981.04.07  
HOTCA 04

## BLETA DHE FLUTURA

Një ditë qershori,  
tek një lule e bukur,  
nikoqirja bletë  
takoi një flutur.

Bleta, me nektar  
plot ishte ngarkuar,  
flutura qe stolisur,  
lyer, parfumuar.

— Me ç'po shoh, — tha bleta,  
sot paske pushim.


— Jo, — përgjigjet flutura,  
kam lënë takim.

Unë punën s'e duroj,  
më prish freskinë e shtatit...

Sot do të filloj  
muajin e mjaltit.

— Gëzohem, — i tha bleta,  
por për mjaltë mos m'u mburr!

Ty një muaj të kajeta,  
e mua s'më soset kurre.




## **KUR DHELPRA BËHET LUANESHË**

Për disa prapësi që kish bërë,  
luani zët e kish marrë arinë,  
e, që të bëhej mësim për të tërë,  
priste vetëm rastin e violinë.

Erdhi ajo ditë...

U ngrit, e përfshiu,  
ndër këmbë e vuri arinë;  
e shtriu.

Dhelprat, të gjitha,  
nga qenë e nga s'qenë,  
u shkulën e vanë.  
E goditën. e pështynë,  
e shanë.



«S'më vjen keq, — tha ariu,  
pse më mundi luani  
dhe më shtriu në shesh  
por... vetëm për dhelprën,  
që u bë luaneshë».

## **S H K È L Q I M I**

Hëna tokës i thotë një ditë:  
— Unë kam më tepër dritë,  
shkëlqim dhe bukuri,  
jo më kot poetët më thurin lavdi.  
Jam në qielj një xhevahir...  
Shpesh dhe ty të ndriçoj,  
natën në errësirë.  
— Po, i thotë toka,  
të falenderoj  
për dritën që më jep mua,  
veç desha të të kujtoj,  
se atë dritë  
edhe ti, (në s'gaboj)  
si unë,  
e merr hua.

## **GRERA DHE BLETA**



Ish te një ditë e nxeh të  
behari;  
një grérë dhë një bletë  
u takuan  
mbi një fije bari.  
Si u përshëndetën  
dhe nxorën mallë,  
kémbyen këto fjalë:  
— Lum ti, — shtoi grera,  
se ta heq dera  
nderin dhe lavdinë.  
Të gjithë kujdesen,  
të të rregullojnë shtëpinë.  
Mua deri më sot,  
askush s'më çmoi,  
ndonëse pitet  
i bëjmë njësoj.

— Ashtu është, — tha bleta, —  
veç mos harro kunatë,  
të tuat janë të lehta,  
të miat janë me mjaltë.

## **PREOKUPIMI**

Pleshti qe shtrirë  
në një shtrat të butë,  
pranë tij merimanga  
u ul me parashutë.

- Si je, o plesht, pelivan?  
Herët qenke ngritur!
- Që lart në tavan  
të pashë se je mërzitur.
- Derr jam bërë, moj motër  
dhe s'di se si do dal.
- Çdo ditë e çdo natë  
dëgjoj po ato fjalë:
  - Byrekun sot e kiske qarë,
  - Tava donte dhe pakëz piper.
  - Ky model s'ka të sharë...
  - Merre në frigorifer...
- Dhe shpesh përemrat:
  - «E imja», «i imi»,  
pastaj qetësi.
  - Ky është gjithë preokupimi,  
në këtë dhomë qeli.



## S H Q E T E S I M

Dy majmunë  
një të shtunë  
bisedonin me maraz,  
në kafaz:  
— Koha ka ndryshuar.  
Dikur,  
për të na vizituar,  
vinin me shumicë,  
njerëz të çdo moshe,  
sa bëheshin kapicë,  
bosh nuk mbetej qoshe.  
Pa na shikonin,  
si i imitonim,  
e diçka thoshin.  
— Ashtu vërtet,  
kishte lezet  
ajo kërshëri,  
kafshët e tjera  
na kishin zili.




— Lere, ç'e kujton  
atë kohë të shkuar,  
më pikon në zemër,  
(tha majmuni femër).

— Ç'është kjo punë,  
nuk di, përse  
nga ne u larguan?

— Ja, ta them unë,  
që kur zunë  
të na imitojnë  
disa gagarela,  
ne... na ra vlera.

## **EZOPI DHE GOMARI**

Gomari tek Ezopi  
një ditë u ankua:  
— Pse, kur lexojnë  
fabulat e tua,  
të gjithë qeshin,  
e tallen me mua?  
Nga kjo padrejtësi  
jam prekur shumë,  
prandaj të lutem  
shihe këtë punë.  
Nxirr dhe një fabul  
të padëgjuar,  
ku unë të dal  
i mençur, i zgjuar.  
— Këtë s'e bëj dot,  
i thotë Ezopi,



është punë me zarar...,  
se bota ty  
do të të quante Ezop,  
dhe mua gomar.

VJERSHA SATIRIKE

## **FLETA E PEMËS**

Për shkollën e drejtor Lonit  
flisnin me respekt  
shokët e seksionit.

Shkova në një orë mësimi,  
florën e Shqipërisë kishin si temë.  
I vetmi mjet konkretizimi  
ishte një fletë nga një pemë.

Dhe ajo s'kishte hyrë nga dera,  
prej dritares e kishtë sjellë era.



## **KA DIÇKA TË HUAJ**

— Kjo triko,  
më tha një ditë Sopotë,  
duket që është mall importi.

— Jo, — i thashë,  
jeni gabuar,  
për këtë ju siguroj,  
në vend është prodhuar.

— Mundet, por ky fill  
s'është i kombinatit.

— Ke të drejtë,  
është lesh nga dhent' e fshatit.

— S'ka mundësi!

Këtu patjetër ka diçka të huaj.

— Po, ka vërtet,  
... në kokën tuaj.




## **BUKA E VJETËR**

— Të lumtë!  
më tha shoku Pjetër,  
— u tregove «burrë»!  
Sa shpejt harrove bukën e vjetër,  
s'e prisja nga ti kurrë,  
të rrëzoje në provim  
Aurelin tim.  
— Djalit tënd, — i thashë,  
s'kisha ç't'i bëja tjetër,  
në provim më erdhi byk.  
Më vjen keq...  
më tepër për ty «buk’ e vjetër»,  
që paske zënë myk.



## K T H E S A

Kur u caktova në punë,  
s'di as unë,  
pse drejtori në zyrë  
më priti hundë e buzë,  
i ngrysur në fytyrë.  
Në të thella s'hyra,  
mendova:  
«Do të jetë nursëz  
nga natyra.»  
Pashë se isha gabuar.  
Një të hënë më priti  
me përzëmërsi të tepruar,  
sa më la të hutuar.  
Ç'të ishte vallë  
gjithë kjo delikatesë?  
Më pas i rashë hilesë:  
Që kur më pa  
me zëvendësministërin,  
shoku drejtor bëri kthesë.



## **BALLAFAQIMI**

— Dhe Ariani, tha Minai,  
na u fejua!

— Vërtet, i thashë, ç'thua?!

— Po, po, nusen



ia gjeti xhaxhai...

Të djelë, në bulevard përjashta  
u panë në një ballafaqim,  
u pëlqyen nga kashta  
dhe bënë celebrim.

— Të vjen çudi kur e dëgjon,  
ishte vetë shoku Arian,  
që për dashurinë  
na fliste me pasion.

— Gjithë fajin e ka kashta,  
që ka aftësinë  
të mdezë në zemrën e djalit  
dhe të vashës,  
dashurinë,  
që zgjat sa flaka e kashtës.

## **BARUT I THATE**

Kur zbret poshtë në terren,  
menjëherë shpërthen  
si barut i thatë.

Por kur vjen dikush nga lart,  
edhe po të jetë verë  
e koha të bëjë thatësirë,  
ty, menjëherë  
baruti të merr lagështirë.



## **VITRINA DHE BANAKU**

Vitrina dhe banaku u zunë  
në një ditë të bukur me diell,  
e acaruan konfliktin aq shumë,  
sa e ftuan shoku-shokun në duel.

Debatin, e para, e nisi vitrina:  
— Pse s'pastrohesh, po rri kaq i ndytë?  
Pluhur ke mbi shpinë dhe mbeturina,  
sa kur të shoh më dhëmbin sytë.

— Në të dhëmbin sytë kërko ndihmë nga optika,  
i thotë me mendjemadhësi banaku,  
mos më shih mbi supe disa pika,  
por shiko më mirë,  
ç'më ka brenda barku.

Dhe ta marrësh vesh, shoqja vitrinë,  
kam mallra të kualitetit të parë,  
jo një e dy, por me dyzinë,  
që zotërote as në ëndërr s'i ke parë.

Ty shitësi ta ka kallur dambllanë,  
prandaj po pëlqet prej zilisë,  
dhe mirë ta bën, se je vetëm për reklamë,  
kurse unë shërbej për miq e farefis.

— S'i s'ke turp, — ia ktheu vitrina  
e vrarë tepër në sedër,  
nga një i mbushur me mbeturina  
nuk ke ç'të presësh më tepër...

**«ME HAPIN E KOHËS»**

Të bëhesh për shefin  
urë në sytë e botës,  
sot, për servilin  
s'është aspak e modës.

Shpesh, para eprorit,  
kur rasti e bie,  
duhet manovruar  
me takt edhe shije.

Nëse, fjala vjen,  
ngrihet një punëtor  
dhe vë fletërrufe  
për shokun drejtor,

FLETERRUFF  
SHEFIT:

MENDIM  
SKA SI  
SHEFI

Pa u tharë boja,  
pa u ndezë fitili,  
përgjigjen e parë  
ta japë servili,  
duke mënvizuar  
çdo fjali e frazë:  
— Shokë, kjo akuzë  
nuk ka asnje bazë.

Këtë të vërtetë  
s'e them vetëm unë...  
Shoku ynë drejtor  
shëmbull është në punë.

Një tjetër problem  
të na shqetësojë:  
Rrezik që ngarkesa  
fare ta shkatrrojë...

\* \* \*

Duhet të veprosh  
me stil ideal,  
në do që të jesh  
servil aktual.

është në fiftë përsë  
në tifëzë fitit  
Dëgjitur e bërg  
në lëvizje serave  
e mëdha dinavizat  
**MËSUESI DHE GALILEU**  
— Shkak kjo teknikë


është ora e fizikës.  
Në klasë

ka rënë qetësi **absolute**.  
Mësuesi vizaton në dërrasë  
grafikun e një **amplitude**.  
Dikush lëvizzi  
pak andej nga fundi ,  
mësuesi durimin e humbi:

— Kush lëviz?  
Flisni kush?  
— Dheu —  
foli dikush.  
Mësuesi kokën ktheu

dhe shpërtheu:  
— Kush e tha? \* \*  
— Galileu.

(Një zë përshtypëriti ngadalë)  
— Galileu jashtë të dalë omi  
dhe të mos i shohë surrjanë,  
pa sjellë në shkollë babanë!



## **POROSITË E MËSUESIT ALI**

Gati çdo ditë,  
nxënësit i porosit,  
mësuesi Ali:

— Në klasë  
ju dua të rregullt,  
të larë e të pastruar...  
Vetë vjen i parruar.



Duhet të lexoni,  
të lexoni jashtë masës.  
Vetë lexon,  
vetëm emrat e klasës.

## E D U K A T E

— Ta kesh vath në vesh, Artan!  
(Djalit moral i bënte atë ditë.)  
Të mos pish kurrë duhan,  
se të prishen mushkëritë.

Veç të këqia sjell duhani,  
është si të blesh belanë me pare.  
E ke të qartë?  
Tani shko më bli një «Partizani»,  
se m'u ça hunda për cigare.

## TE TRASHEGOHESH

- **Té trashégoħesh!**  
Mé tha shoku Llazar,  
duke mē pérqafuar.  
Hé, c'paske qené  
njé thëngjill i mbuluar,  
njé shpużé,  
dhe mē puthi nē buzé.  
Mbeta i hutuar.
- More avash, i thashé,  
une i fejuar?  
As ndér mend s'me ka shkuar  
ndonjéheré.
- Léri nazet  
dhe eja na jep  
nga njé gotë verë,  
duhet lagur kjo ditë...
- Po mē habit...
- Marika sa mē tha,  
se tē kishin parë

me tē fejuarën nē kinema.

— Po, nē kinema  
isha vërtet,  
aty nga fundi i javës  
me gocën e hallës,  
or me ~~sazd~~ unë, ~~llat~~  
aty shkohet për film  
dhe jo për tē bërë celebrim.

— Zgjedhni më të tia që dësh


Atotonit që pëngjedësin  
Bës që do t'zj. është filmi më të mirë  
më avulli që t'zj. është

që do që dësh më këtë mëngjesit  
Kur qëndrohet rreth do të përfshi  
Sipas tij njësim jetëmbretit  
do kthej bës më të besportit


## **FAJI DHE VESHI**

— Xhaxhi, më tha një ditë  
Agroni dhe buzëqeshi,  
për çdo faj që bëjmë ne fëmijtë,  
mos vallë e ka fajin veshi?!

Se çdo ditë në klasë mësuesja,  
kur dikush nga ne gabon,  
sikur të ishim lepurusha,  
na kap për veshi, na peshon!



## **SHOKU BARDHYL**



Gjithë studentëve,  
para provimit,  
të qartë ua bëri  
shoku Bardhyl,  
se perëndoi ylli i lëshimit  
askush s'do të kalonte qyl.  
Poblemin e cilësisë  
ai e kapi si burrë,  
vërtet pak me vonesë,  
po më mirë vonë se kurre.

Nga tridhjetë që tërhoqën-tezë,  
kaluan vetëm pesë.

Dhe ata s'do kishin dalë nga vrima,  
por i ndihu «vitamina».

Shoku Bardhyl e ka parim:  
«Pa djersirë,

askush në provim  
s'i shpëton rrezikut».

Nga ky rregull bën përjashtim,  
vetëm miku i mikut.

METAMORFOSA E NDE DITËV

✓ Në qytetin e Shkodrës, me një kafshë  
më e madhe se gjithë qyteti, që  
nëpërkatët e tij, që  
në këtë kohë kishin mund të jenë

✓ Më së shumti kështu, më shumë, që qarku  
më i madhi, që përfshin  
më shumë se një qytet — më shumë  
që qarku e qytetit që përfshin

✓ — është qyteti i Shkodrës, që  
nëpërkatët e tij, që  
në këtë kohë kishin mund të jenë

## **METAMORFOZA E NJË DRAME**

Një dramë shkrova me frymëzim,  
vrapova në teatër pa vonesë.  
«Duku, më thanë, për njoftim  
si të kenë kaluar muaj nja pesë.»

Muajt kaluan, unë prap' u duka,  
drejtori më priti buzëgaz  
me sa duket e hodha, — mendova  
po dardha e paska bishtin pas.

— Drama juaj tëpër më pëlqen,  
ngre probleme, bën përgjithësime...  
Jemi gati ta vëmë në skenë,  
si të bëni këto e këto ndryshime.

Pas ndryshimeve e mori regjizori,  
ai vërejtje të tjera kish padyshim  
më pas ndihmësi, aktori, piktori...,  
s'mbeti njeri pa dhënë një mendim.

M'u desh t'ia nis pesë herë nga fillimi  
për çdo vërejtje vec e vec,  
derisa drama ime «Pendimi»,  
një ditë përfundoi në ... skeç.

Unë të paktën fitova përvojë,  
kjo ka më tepër rëndësi,  
pa skeçin mund t'a çoj në estradë,  
e ta kthej në dramë përsëri.

„Bëz këtë përfundim e s'kemi që përfundim  
marrëzveq është vrojt e një përfundim  
i tij, i cili përfundon me një vëllim  
i lindur me gjithë vëllat që kanë lindur

rrëfisi i **RRIPI DHE ZINXHIRI** është këtë  
që është e rëndësishëm që është  
rrëfimi i përfundimit të vëllave  
që ka... është një rrëfim i përfundimit të vëllave

Shëtitje bulevardit

dolën në mugëtirë

një rrip i gjere

(nga ata të **NTSHAP-it**)

dhe një zinxhir,


I pari shqëronë

pantollonat e ngushta në gju,

i dyti surratin nakatosur

me të kuq e blu.

Një fshatar,  
(kish zbritur në qytet)  
i pa ziliqar,  
dhe, i tha  
shokut që kishte në krah:  
— A s'është gjynah  
të venë dëm



kjo kapistér      punq më punq  
 dhe ky palldëm?      njo shkurt  
 Shoku e dëgjoi,      pëqpon tófkuq  
 pastaj shfaqi, **mëndimin evet!**  
 — Mos harro, **xha Refat**,  
 kuaj ka dhe në qytet,      është më  
 ashtu, **si në fshat**,      ikuja në qytet

## **VESH MË VESH**

«Vetëm ty po ta tregoj,  
dhe besoj,  
se do ngelet midis nesh...»  
thashethemet qarkullojnë  
vesh më vesh.

Kafeneve  
venë e vinë  
me zë të lehtë,  
nga tavolina në tavolinë,  
buzë më buzë,  
ato zgjaten,  
bëhen tërkuzë.  
Fije marimangash,  
thashethemet enden...  
«E more vesh?  
Lakja ngrihet në përgjegjësi.

Shabanin e zëvendëson Bilali,  
shkon me ulje,  
për çështje morali».

Tjerrin thashetheme  
dhe ca me «kulturë»  
e shpirt të sëmurë...

Si pula vezët,  
ngrohin thashethemet  
mikroborgjezët.



## KONDITA

Së tepërm keni përparuar,  
(ndodhin në botë dhe mrekulli!)  
për vajzën keni pranuar  
të martohet me dashuri.

Vetëm se një konditë  
i vutë çupës suaj Shpresës:  
«Dashuria s'duhet t'i lindë  
para... martesës».


## **SHOKU KRISTOFOR**

Eshtë absurditet,  
të quash konservator  
shokun Kristofor.  
Po flas me shumë kompetencë,  
s'ka mbledhje apo konferencë,  
të mos dërmojë nga tavolina  
njerëzit me mbeturina.

Vajzës së tij vërtet  
ia ka mbledhur shoku Kristofor,  
se s'ka fare lezet  
të dashurojë ajo një punëtor.  
Kjo është marrëzi,  
si mos të tërbohet Kristofori,  
kur kishte mundësi  
të merrte një burrë  
(të paktën)  
në rang ambasadori?!

## **PA SKRUPULL**

Ndodhi si në përrallë.  
Në zyrë unë  
dhe telefon i përballë,  
mbi tavolinë.  
Receptor i ngadalë  
çohet  
dhe prish qetësinë:  
— Ne telefonat  
qenkemi shumë të duruar,  
e kemi barkun të gjërë  
si napë.  
I dëgjojmë të tërë  
kur flasin mbarë e prapë...  
Nganjëherë na vjen ndot  
dhe kemi siklet,  
por prapë durojmë...  
Të fortë jemi vërtet!  
Vetëm tërbimi na hipë,



kur dikush pa skrupull  
ndérhyn pér nipin,  
se mbesën bukuroshe...  
t'u sigurojë ndonjë «qoshe».

## **ART MODERN**

— E mrekullueshme Xhek, ollrajt,  
këtij i thonë art modern!  
Por të lutem tregoi vëllait  
është, njëri, gomar, apo qen?



— Më vjen keq, Xhon i shkretë,  
pse pyet si shumë të tjerë,  
sikur unë ta dija vetë,  
vepra s'do të kishte vlerë.

---

\*) shumë mirë (anglisht).

## **MURI DHE «PIKTORI»**


Ndërsa shokët po i thonin:  
«Ti paske shije të hollë»,  
muri po skuqej nga turpi,  
në të ish varur një njollë.

## **EPOPEJA E VJESHTUKËVE**

Siq mund të ketë  
kallinj pa bukë,  
ka dhe studentë,  
u thonë vjeshtukë.

Vjeshtukët njihen,  
nuk është zor,  
para të tjerëve,  
vinë në shtator.

Vinë prej qytetit,  
vinë prej katundit...  
Duhet provuar  
fisheku i fundit.



Vinë të tulatur,  
nuk thonë një fjalë,  
shkojnë nëpër rrugë  
si «illegalë».

Hapin shpejtojnë,  
çantat në duar,  
të sëkëlldisur,  
të dëshpëruar.

Janë në siklet,  
s'dinë si po dalin  
dhe shoku-shokut  
i qajnë hallin:

— Si je Arian?  
A ke mësuar?  
Sa paske rënë!  
Je dobësuar!

— Mbi leksione mbeta,  
mbeta mbi dispensë,  
s'kam as pretendime,  
veç një copë pesë.

— E ç'duhet më shumë  
se një pesë e çalë,  
sa të hedhim lumin,  
pastaj bëjmë pallë.

Bëjn' pallë vërtetë,  
darkë e mëngjez;  
në fakultet  
nuk ngrohin vezë.

Pa vinë vërdallë  
si kali në duaj,  
një palë këpucë  
grisin në muaj.

Dhe kur u thua:  
— Ku jeni shokë?!  
Ta kthejnë serbes:  
«S'jemi peshkopë,

që s'kanë haber  
fare nga jetë,  
po venë e myken  
në biblioteka.

Të mbyllesh brenda  
nuk ka kuptim.  
Sa për provim  
boll një lexim».

Dhe çajnë ferrën  
poshtë e përpjetë,  
e livadhisin  
si hergjeletë.

Ua mbledh rripat  
vetëm shtatori...  
Djersijnë nga halli,  
djersijnë nga zori.

«Pse?!... Kam mësuar!...»  
(I skuqen veshtë)  
— Urdhëro librezën:  
Eja në vjeshtë!

Kur dalin jashtë:  
«Nuk pata fat,  
ose profesori  
më kish inat».

Lëvizen gurët,  
për të ndërhyrë  
dhe kur kalojnë  
veç me të shtyrë.

Vjeshtukët janë  
edhe fodullë,  
hiqen të aftë  
dhe me kulturë.

Flasin për shkencë,  
filozofi,  
për art, muzikë  
dhe letërsi.

Vrasin shumë lart  
në muhabet,  
«dhi e zgjebosur,  
bishtin përpjetë».

Vetëm në vjeshtë  
u humbet vula,  
u bien pendët,  
e bëhen pula.

Dhe si u digjet  
karta e fundit  
i venë qytetit,  
i venë katundit.

Kallinj pa bukë  
vjeshtukët janë,  
prandaj dhe shosha  
i nxjerr mënjanë.

**1973**

## **VITI I RI DHE NJË BUROKRAT**

Kur radha i erdhi dollisë  
për të uruar Vitin e ri,  
burokrati pa e çuar gotën e rakisë  
u ngrit e tha:  
— Nuk duhet nxituar,  
mendoj për nesër  
ta lëmë dollinë,  
t'i shohim edhe një herë...  
biografinë.

## **NJË SKEPTIK**

Edhe më parë e kam theksuar:  
Për Vitin e ri kam konsideratë,  
por prap' le për të dyshuar:  
se vjen përher' veç në mesnatë.

## **THASHETHEMEXHUT**

Tek pinte një «kafe me pak»  
mbështetur mbi banak,  
shokut i pëshpëriti «një sekret»:  
— Dëgjuat shoku Pjetër?  
Ky vit zëvendësohet nga një tjetër.  
Eshtë e sigurt,  
i zë vendin një i ri...  
pushohet për paaftësi.

## **NJE KOPRAC.**

Hallall t'a bëj gostinë,  
(kështu e don adeti)  
dhe verën dhe rakinë  
dhe tavën me gjel deti..

Sikur të vije ditën...  
Ish më ekonomike,  
diçka do të kursenim  
nga drita elektrike.

## **NJË KARIERIST**

Për ty me fund  
do ta pi dollinë,  
për ty jam gati  
ta përmbysh shtëpinë.  
Këtë ndër e meriton...,  
nxjerr shefin në pension.

## **NJE TEKNOKRATI**

I thanë:

— Po vjen Viti ri,  
turnin fillon në mesnatë.

Ai tha:

— Përmua ka rëndësi  
të ketë kategorinë e shtatë.

## **DISA SHKRIMTAREVE**

Dhe pa ardhur Viti ri,  
unë e di,  
ju sërishmi do filloni  
të premtoni,  
për vëllimet që do marrim.  
Mos vallë e ngatërroni  
një prillin me një janarin?!

## **NJË KINOREGJIZORI**

Kush tha «nuk je aktivist»?  
Ti po shkëlqen si meteor,  
në regji si skenarist  
dhe në skenar si regjizor.

## **NJË KRITIKU**

Kritikën e kishe tharë,  
s'i kurseve bateritë  
ndaj autorit, që dhjet' vjet më parë  
të kish kthyer poezitë.

## NJE POETI

Poezinë e botuar në gazetë  
e lexova në fillim qetë-qetë,  
e rilexova me durim disa herë...  
nuk po gjeja, për të hyrë asnje derë.

Von', shumë vonë e zgjidha sferën,  
Odisenë e kësaj «kulture»,  
Eshtë vështirë të gjesh derën  
në një vend, ku s'ka as mure.

## **NJE ORËNDREQESI**

E shoh,  
qenke mjeshtër i mbaruar  
orën mirë m'a rregullove,  
jo vetëm që s'mbetet prapa,  
por është bërë dhe novatore.  
Ka vrapuar aq, të shkretën,  
sa punon për tetëdhjetën.

## **NJE SHITESI**

Bukur fort e paske nisur,  
shpjere në fund,  
bëje tamam,  
kilen e ke katandisur  
... nëntëqind gram.

## NJË BERBERI

Ty «të lumtë» ajo gërshërë,  
kur më gjen të tillë truthatë,  
flokët ja u lë të tërë  
dhe u qeth vetëm paratë.

## NJE SHOQES SIME

Ti, që aq shumë deshe Mentorin  
e në fund mire Nexhdetin,  
nuk e di,  
u martove me televizorin,  
apo me kryeqytetin?!

## **PASQYRA E LËNDËS**

### **FABULA**

	Faqe
S'përsëritet fabula .....	5
Sa për dijeni .....	8
Dhelpra dhe fiqtë .....	10
Helmimi .....	13
Minjtë e ugarit .....	15
Bleta dhe flutura .....	17
Kur dhelpra bëhet luaneshë .....	19
Shkëlqimi .....	21
Grera dhe bleta .....	22
Preokupimi .....	24
Shqetësimi .....	26
Ezopi dhe gomari .....	29

### **VJERSHA SATIRIKE**

Eleta e pemës .....	33
Ka dicka të huaj .....	35
Buka e vjetër .....	37
Kthesa .....	39
Ballafaqimi .....	41
Barut i thatë .....	43
Vitrina dhe banaku .....	45

Faqe

Me hapin e kohës .....	47
Mësuesi dhe Galileu .....	50
Porositë e mësuesit Ali .....	52
Edukatë .....	53
Të trashëgohesh .....	54
Faji dhe veshi .....	56
Shoku Bardhyl .....	58
Metamorfoza e një drame .....	60
Rripi dhe zinxhiri .....	62
Vesh më vesh .....	64
Kondita .....	67
Shoku Kristofor .....	68
Pa skrupull .....	69
Art modern .....	72
Muri dhe «piktori» .....	74
Epopeja e vjeshtukëve .....	75

**EPIGRAME**

Viti i ri dhe një burokrat .....	85
Një skeptik .....	86
Thashethemaxhiut .....	87
Një koprac .....	88
Një karierist .....	89
Një teknokrati .....	90
Disa shkrimtarëve .....	91
Një kinoregjizori .....	92
Një kritiku .....	93
Një poeti .....	94
Një orëndreqësi .....	95
Një shittësi .....	96
Një berberi .....	97
Një shoqes sime .....	98